



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER JULIAN ZHELEGU
ADRESA Njesia Bashkiake nr. 5, Rr.
Pjeter Bogdani, Godina Nr. 13, Hyrja Nr.
2
TEL: 042255528



KONTRATË DHURIMI PASURI E LUAJTSHME (AKSIONE)

Nr. repertori: 317

Nr. koleksioni: 114

Tirane më 16/01/2024

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



A2024053950009284266

“Taksa e Pullës u Likuidua”



KONTRATË DHURIMI AKSIONESH

Në Tiranë, sot, me date 16 / 01 / 2024 (dy mijë e njëzet e katër), në zyrën noteriale të Noter Julian Zhelegu, Noter i Dhomës së Noterëve Tiranë, në adresën Rr. Pjeter Bogdani, nr. 13, K. I, Tiranë, përpara meje Zëvendësnoteres Elsa Gurra, e autorizuar rregullisht nga Noteri Julian Zhelegu, për redaktimin e akteve dhe veprimeve noteriale gjatë mungesës së tij, u paraqitën dhe kërkuan redaktimin e këtij akti palët e mëposhtme.

Dhuresi: Fuad Haxhiymeri, atësia Hajredin, amësia Florina, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë Papa Gjon Pali II; Nd. 34; H. 1; Njësia Administrative Nr. 2; Njësia Bashkiake Nr. 2; 1017; Tiranë, lindur më 28/01/1964, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033687416 dhe nr. personal G40128172R; (në vijim e për efekt të kësaj Kontrate referuar si “Dhuresi”);

dhe

Pranuesi i dhurimit: Agron Haxhiymeri, atësia Hajredin, amësia Florina, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë Papa Gjon Pali II; Nd. 5; H. 1; Ap. 1; Njësia Administrative Nr. 2; Njësia Bashkiake Nr. 2; 1017; Tiranë, lindur më 24/03/1967, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 038232256 dhe nr. personal G70324117E; (në vijim e për efekt të kësaj Kontrate referuar si “Pranuesi i Dhurimit”);

Në vijim e për efekt të kësaj Kontrate, Shitësi dhe Blerësi do të referohen veçmas si Palë/a dhe së bashku si Palët/t.

MEQENËSE:

- Shoqëria “BLOJA” SHA. (më poshtë referuar si “Shoqëria”), është një shoqëri aksionare e krijuar e që funksionon në përputhje me legjislacionin shqiptar, regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me Numër Unik Identifikimi J61817056C, me seli në Tiranë, Njësia Bashkiake nr.6, Rruga “Konferenca e Pezës”, ZK 8240, nr. pasurie 2/137 dhe 2/138, fabrika e shoqërisë “Bloja” sha, me kapital themeltar 1.209.649.000 leke, të ndare në 1.209.649 aksione me vlerë nominale 1.000 leke secili.
- Siç rezulton nga ekstrakti i regjistrimit tregtar lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit për të dhënat e Shoqërisë, Dhuresi zotëron 552752 (pesëqind e pesëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e dy) aksione, që përfaqësojnë 45,41% (dyzet e pesë presje dyzet e një përqind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë (në vijim “Aksionet”).
- Dhuresi i ka njoftuar Pranuesit të Dhurimit dëshirën e tij për të transferuar në pronësi të Pranuesit të Dhurimit Aksionet e zotëruara prej tij në kapitalin e regjistruar të Shoqërisë dhe Pranuesi i Dhurimit ka pranuar të fitojë pronësinë mbi Aksionet e ofruara nga Dhuresi në Shoqëri, sipas parashikimeve të kësaj Kontrate. Dhuresi dhe pranuesi i dhurimit janë në marrëdhënie gjinore, vëllezër.

ATËHERË, duke qenë se ekzistojnë këto kushte paraprahe, për të cilat Palët nuk kanë pretendime apo kundërshtime, Palët bien dakord për sa më poshtë vijon:

Neni 1

Objekti i Kontratës



A2024053950009284266

- 1.1. Dhuruesi transferon ne pronësi te Pranuesit te Dhurimit dhe Pranuesi i Dhurimit bie dakord që të fitojë nga Dhuruesi Aksionet qe Dhuruesi zotëron ne kapitalin themeltar te Shoqërisë dhe konkretisht 552752 (pesëqind e pesëdhjete e dy mijë e shtatëqind e pesëdhjete e dy) aksione, që përfaqësojnë 45,41% (dyzet e pesë presje dyzet e një përqind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë "BLOJA" SHA. me NUIS J61817056C.
- 1.2. Aksionet e zotëruara nga Dhuruesi ne kapitalin e shoqërisë transferohen ne favor te Pranuesit te Dhurimit, pa kundërshtëpërblim, pa pengje, barra apo kufizime te asnjë lloji.
- 1.3. Palët bien dakord qe te drejtat qe rezultojnë nga pronësia mbi Aksionet e kapitalit transferohen me lidhjen e kësaj Kontrate te Pranuesi i Dhurimit.

Neni 2 Deklarimet dhe garancitë e Dhuruesit

- 2.1. Dhuruesi pranon se deklarimet e mëposhtme janë të vërteta, të plota dhe nuk përmbajnë keqinformime në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate:
 - Dhuruesi ligjërisht e në momentin e nënshkrimit zotëron Aksionet që do të transferohen sipas kësaj Kontrate, dhe ka të drejtën për t'i transferuar ato.
 - Nënshkrimi apo zbatimi i kësaj Kontrate nga Dhuruesi nuk vjen në kundërshtim me ligjet, Statutin, kontratat, marrëveshjet apo dokumente të tjera ligjore, subjekt i të cilave është Dhuruesi.
 - Dhuruesi do te përgjigjet për çdo detyrim apo përgjegjësi qe rezulton nga zotërimi i Aksioneve ne lidhje me Shoqërinë deri ne ditën e lidhjes se kësaj Kontrate, duke mbajtur Pranuesin e Dhurimit te padëmtuar dhe te mbrojtur kundër çdo pretendimi ose kërkesë.
 - Çdo deklarim apo garanci e dhënë nga Dhuruesi sipas kësaj Kontrate nuk përmban gabime materiale apo ometime.

Neni 3 Deklarimet e Pranuesit te Dhurimit

- 3.1. Pranuesi i Dhurimit pranon se deklarimet e mëposhtme janë të vërteta, të plota dhe nuk përmbajnë keqinformime në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate:
 - Pranuesi i Dhurimit ka tagra të plota për të pranuar pjesët e kapitalit nga Dhuruesi sipas përcaktimeve të kësaj Kontrate.
 - Nënshkrimi apo zbatimi i kësaj Kontrate nga Dhuruesi nuk vjen në kundërshtim me ligjet, kontratat, marrëveshjet apo dokumente të tjera ligjore, subjekt i të cilave është Pranuesi i Dhurimit.

Neni 4 Transferimi i të drejtave mbi pjesëmarrjen

- 4.1. Pronësia mbi Aksionet, objekt i kësaj Kontrate, kalon nga Dhuruesi tek Pranuesi i Dhurimit menjëherë me lidhjen e kësaj Kontrate. Kalimi i pronësisë së Aksioneve të Shoqërisë në favor të Pranuesit do të regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit në përputhje me Ligjin 9901/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, dhe Ligjin 9723/2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar, si dhe pranë çdo institucioni tjetër shtetëror sipas legjislacionit në fuqi.
- 4.2. Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Dhuruesi humbet çdo të drejtë lidhur me Aksionet që transferohen nëpërmjet kësaj Kontrate, përfshirë të drejtën e ushtrimit të votës në mbledhjet e Asamblesë dhe ndarjes së fitimeve që rrjedhin nga zotërimi i tyre. Të gjitha të drejtat, që sipas Ligjit, burojnë nga zotërimi i Aksioneve te dhuruara sipas kësaj Kontrate, i transferohen Pranuesit te Dhurimit dhe ky i fundit bëhet titullar i vetëm i ligjshëm i Aksioneve.



- 4.3. Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Dhuruesi gëzon të gjitha të drejtat për të regjistruar pronësinë mbi Aksionet në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit si dhe pranë çdo institucioni tjetër shtetëror sipas legjislacionit në fuqi.
- 4.4. Me lidhjen e kësaj Kontrate, Dhuruesi largohet nga Shoqëria pasi nuk zotëron me pjesëmarrje ne kapital.

Neni 5 Të ndryshme

- 5.1. Çdo kusht, klauzolë apo parashikim i kësaj Kontrate do të jetë i vlefshëm pavarësisht kushteve, klauzoleve apo parashikimeve të tjera dhe vlefshmëria e një kushti, klauzole apo parashikimi nuk do të cenohet nga pavlefshmëria e një kushti, klauzole apo parashikimi tjetër.
- 5.2. Kjo Kontratë do të interpretohet dhe zbatohet në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe të çdo dispozite tjetër rregulluese sipas legjislacionit shqiptar të aplikueshëm.
- 5.3. Çdo konflikt që ka lindur si pasojë apo lidhet me këtë Kontratë do të zgjidhet në marrëveshje ndërmjet Palëve, në rast të kundërt kompetente për zgjidhjen e konflikteve është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- 5.4. Kjo Kontratë hartohet në gjuhën shqipe në 4 (katër) kopje origjinale.

Kontrata u lidh ne praninë dhe me miratimin e bashkëshortes se dhuruesit, znj. **Elena Haxhiymeri**, atësia Stefan, amësia Fatime, shtetase Shqiptare, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë Papa Gjon Pali II; Nd. 34; H. 1; Njësia Administrative Nr. 2; Njësia Bashkiake Nr. 2; 1017; Tiranë, lindur më 01/09/1966, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 038219052 dhe nr. personal G65901049Q, e cila deklaroi se jep pëlqimin dhe miratimin e saj te plote per përmbushjen dhe ekzekutimin e kontratës sipas te gjithë kushteve dhe afateve te mësipërme.

Kontrata u redaktua nga unë Zëvendësnoteri sipas kërkesës se palëve ne gjuhen shqipe dhe ne 4 kopje origjinale, dhe pasi iu lexua dhe iu shpjegua palëve nga unë Zëvendësnoteri me zë te larte dhe te qarte u kuptua dhe u pranua prej palëve, u nënshkrua rregullisht dhe pa vërejtje prej palëve ne praninë time dhe unë, Zëvendësnoteri, e vërtetoj sipas ligjit dhe për te gjithë efektet e tij dhe e nënshkruaj rregullisht sipas autorizimit të Noterit Julian Zhelegu.

DHURUESI

Fuad Haxhiymeri

PRANUESI I DHURIMIT

Agron Haxhiymeri

Miratuesi

Elena Haxhiymeri

NOTERI

Julian Zhelegu

Me autorizim

Zv. Noter Elsa Gurra



Julian ZHELEGU
STUDIO NOTERIALE
Rr. "Pjeter Bogdani", nr. 13
Tiranë, Shqipëri
NIPT: K61717003K

Tel & Fax: + 355 4 22 555 28 Mobil: + 355 68 20 27 818 E-mail: noteri@studiozhelegu.net

Nr. 1 Prot.

Tiranë, më 15.1.2024

AUTORIZIM



Bazuar ne nenin 66/3 te Ligjit 110/2018 "Për Noterinë" dhe duke qene se nuk do të ndodhem në Republikën e Shqipërisë prej datës 16.1.2024 (gjashtembdhjete janar dy dy mijë e njëzet e katër) deri më datë 26.1.2024 (njëzet e gjashte janar dy dy mijë e njëzet e katër), autorizoj Zëvendësnoteren znj. Elsa GURRA, për te kryer shërbimet noteriale kundrejt palëve të treta, duke nënshkruar aktet noteriale dhe veprimet e tjera noteriale. Zëvendësnoterja autorizohet të redaktojë dhe nënshkruajë sipas ligjit aktet dhe veprimet noteriale, pa kufizim të kompetencave.

Afati i ushtrimit të veprimtarisë së zëvendësnoteres Elsa GURRA fillon më 16.1.2024 (gjashtembdhjete janar dy dy mijë e njëzet e katër) dhe mbaron datë 26.1.2024 (njëzet e gjashte janar dy dy mijë e njëzet e katër).

NOTERI
Julian ZHELEGU